



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.17/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Kymete Kicaj kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. protokollit 01/3771-2025, të datës 10.12.2025, për shkak të mos certifikimit të listës së kandidatëve të subjektit politik, për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, që do të mbahet më 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 13.12.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

APROVOHET ankesa e subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. Protokollit 01/3771-2025, të datës 10.12.2025, NDRYSHOHET vendimi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me Nr. Protokollit 01/3771-2025, të datës 10.12.2025, ashtu që PRANOHET rekomandimi i Zyrës për Çertifikim dhe Kontroll Financiar në KQZ, i datës 10.12.2025, ÇERTIFIKOHET lista e kandidatëve (33 kandidat) të subjektit politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor 2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 11.12.2025 PZAP, ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lista Serbe, me seli në Mitrovicën e Veriut, me të cilën e ka kundërshtuar vendimin e KQZ-së të datës 10.12.2025, me nr. 01/3771/2025, duke theksuar se periudha për paraqitjen e kërkesave për verifikimin e subjekteve politike fillon më 24.11.2025 dhe përfundon më 30.11.2025. Në ndërkohë, periudha për paraqitjen e listave të kandidatëve të subjekteve politike të verifikuara nga KQZ fillon më 24.11.2025 dhe përfundon më 07.12.2025. Parashtruesi i ankesës thekson se përfaqësuesi i autorizuar i Listës Serbe në përputhje me afatin e caktuar më 7.12.2025 përmes platformës zyrtare në internet paraqiti kërkesën për certifikimin e 33 kandidatëve për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare në Kosovë që janë planifikuar për 28 dhjetor 2025, Zyrës për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZR VFKSP) në përputhje me afatin e përcaktuar.

Më 10.12.2025, Komisioni Qendror Zgjedhor shqyrtoi rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZR VFKSP) pranë Komisionit Qendror Zgjedhor, në të cilën konstatoi "Zyra ka kryer të gjitha kontrollet e nevojshme të dokumentacionit të aplikimit dhe ka dërguar listën e kandidatëve të partisë politike Lista Serbe në kontrollet e nevojshme në institucionet kompetente lidhur me përshtatshmërinë e kandidatëve në përputhje me kërkesat që rrjedhin nga neni 30 i LZP-së. Kontrolli i listës së kandidatëve nuk ka rezultuar në asnjë gjetje që do të pengonte verifikimin e ndonjë prej kandidatëve të paraqitur në listën e partisë politike Lista Serbe.

Tutje në ankesë theksohet se pas kryerjes së të gjitha hapave të nevojshëm për kontrollin dhe verifikimin e aplikimit të partisë politike Lista Serbe për verifikimin e kandidatëve, Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) rekomandoi KQZ-së verifikimin e tridhjetë e tre (33) kandidatëve të partisë politike Lista Serbe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dhe se Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZRVFKSP) pranë Komisionit Qendror Zgjedhor ka dhënë rekomandim për certifikimin e të gjithë 33 kandidatëve të Listës Serbe bazuar në dokumentacionin dhe dëshmitë që Zyra ka mbledhur nga të gjitha institucionet kompetente të Kosovës, dhe rekomandon KQZ-së të verifikojë të gjithë kandidatët e Listës Serbe për të marrë pjesë në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Kosovës 2025, në përputhje me nenin 30 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës Nr. 08/L-228. Komisioni Qendror Zgjedhor më 10.12.2025, në kundërshtim me rekomandimin e Zyrës me votat e anëtarëve të KQZ-së, refuzoi të certifikojë 33 kandidatët e Listës Serbe, i cili vendim i Komisionit Qendror Zgjedhor është në kundërshtim me nenet e Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, përkatësisht, Komisioni Qendror Zgjedhor ka shkelur nenin 45 të Kushtetutës së Kosovës. Parashtruesi i ankesës thekson se me nenin 73 të Kushtetutës dhe nenin 30 të Ligjit nr. 08/L228 për zgjedhjet e përgjithshme përcaktohen kushtet dhe kufizimet që personat nuk kanë të drejtë të kandidohen dhe në çfarë kushtesh nuk kanë përshtatshmëri të jenë kandidatë në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale. Këto kufizime janë strikte dhe janë përcaktuar saktësisht kategoritë e personave që nuk mund të përdorin të drejtën pasive të votimit (të zgjidhen) dhe komponentën e saj pasive. Nënkuptohej që të tjerët kanë të drejtë duke qenë se Ligji dhe Kushtetuta nuk i kufizojnë në ushtrimin e kësaj të drejte. Rekomandimi i Komisionit me të cilin propozohet certifikimi i kandidatëve të Listës Serbe është më se i qartë dhe është dhënë në mënyrë të ligjshme me respektimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kjo do të thotë se certifikimi i kandidatëve të një subjekti politik nuk është çështje vullneti të mirë i ndonjë anëtari të Komisionit Qendror Zgjedhor, por detyrim ligjor i çdo anëtari të Komisionit Qendror Zgjedhor për të certifikuar çdo subjekt politik që ka plotësuar kushtet e parashikuara me ligj.

Po ashtu në ankesë theksohet se që Komisioni Qendror Zgjedhor të marrë një vendim me të cilin i refuzohet certifikimi i kandidatëve ndonjë subjekti, madje edhe nëse është Lista Serbe, ai është i detyruar në përputhje me pikën 5 të nenit 17 të Ligjit nr. 08/L228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë dhe në përputhje me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës të arsyetojë në detaje cili nga kushtet e parashikuara me ligj nuk është plotësuar, më tej, edhe sikur të ishte kështu, ai është i detyruar në përputhje me pikën 1 të nenit 17 të Ligjit nr. 08/L228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë që, nëse dokumentacioni është i paplotë, ta njoftojë subjektin politik dhe t'i japë afat për ta plotësuar dokumentacionin e paplotë.

Në këtë rast, subjekti politik, Lista Serbe, përkatësisht kandidatët e saj, kanë plotësuar kushtet e parashikuara me ligj dhe kushtetutë, gjë që e ka konstatuar edhe Zyra për Regjistrim, Verifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike (ZR VFKSP) në rekomandimin e saj. Parashtruesi i ankesës kërkon që ankesën si të bazuar, që të konstatojë se vendimi i Komisionit Qendror Zgjedhor për të mos certifikuar kandidatët për deputetë të subjektit politik Lista Serbe është i paligjshëm dhe jo kushtetues dhe se është në kundërshtim me nenet 31 dhe 45 të Kushtetutës së Kosovës, si dhe në kundërshtim me nenet 16, 17, 26, 27 dhe 30 të Ligjit nr. 08/L-228 për zgjedhjet e përgjithshme, që të urdhërojë Komisionin Qendror Zgjedhor që të certifikojë kandidatët e subjektit politik Lista Serbe në përputhje me Ligjin nr. 08/L228 për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë.

Parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur Vendimin për mos certifikimin e kandidatëve të Listës Serbe 01/3771-2025

Në përgjigje në ankesë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, theksohet se në përputhje me Planin Operacional të aprovuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më 28 Dhjetor 2025, periudha e aplikimit për certifikimin e listës së kandidateve të subjekteve politike ka përfunduar më 7 Dhjetor 2025. Subjekti politik Srpska Lista ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim të listës së kandidatëve përmes platformës elektronike më 7 Dhjetor 2025.

Zyra në përputhje obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin e ngarkuar nga Srpska Lista në platformën e certifikimit. Pas kontrollit të dokumentacionit Zyra ka arritur në përfundim se aplikimi për certifikim të kandidatëve është i kompletuar dhe ka proceduar tutje me verifikimin e kandidatëve në lidhje me përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave të nenit 30 të LZP. Nga të gjitha kërkesa e dërguara nga Zyra për verifikim të kandidatëve të subjektit politik Srpska Lista, të gjitha janë kthyer pa të gjetura për kandidatët e prezantuar nga subjekti politik në fjalë, që nënkupton se të gjithë kandidatët e Srpska Lista plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që rrjedhin nga neni 30 i LZP.

Pas përfundimit të të gjitha hapave të nevojshëm për kontroll dhe verifikim të aplikimit të partisë politike Srpska Lista për certifikimin e kandidatëve, Zyra për Regjistrim, Certifikim dhe Kontrollin Financiar të Subjekteve Politike (Zyra) ka rekomanduar KQZ për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Lista të përbërë nga tridhjetë e tre (33) kandidatë. Në takimin Nr.95 të KQZ të mbajtur më 10.12.2025, Zyra ka prezantuar rekomandimin për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Lista për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Rekomandimi i prezantuar nga Zyra, për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Srpska Lista, mori tri (3) vota për, dy (2) vota kundër dhe gjashtë (6) abstenime. Rekomandimi në fjalë nuk mori 2/3 e votave të nevojshme për tu certifikuar siç kërkohej me paragrafin 4 të nenit 63 të LZP.

Rrjedhimisht, aplikimi për certifikim të listës së kandidatëve është refuzuar siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP. Rrjedhimisht, certifikimi është refuzuar siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 17 të LZP dhe është marrë Vendimi 01/3771-2025

Pala është njoftuar menjëherë për marrjen e Vendimit dhe është udhëzuar për të drejtën e ankesës, në përputhje me LZP.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa – PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, gjeti se:

## Ankesa është e bazuar.

Paneli vlerëson se, në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se subjekti politik Lista Serbe, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datën 28.12.2025, ka përfunduar të gjithë hapat e aplikimit për certifikim të listës së kandidatëve përmes platformës elektronike më 7 Dhjetor 2025, dhe se Zyra në përputhje me obligimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, ka kontrolluar të gjithë dokumentacionin e ngarkuar nga Lista Serbe në platformën e certifikimit, dhe se pas kontrollit të dokumentacionit, Zyra ka arritur në përfundim se aplikimi për certifikim të kandidatëve është i kompletuar dhe ka proceduar tutje me verifikimin e kandidatëve në lidhje me përshtatshmërinë e tyre sipas kërkesave të nenit 30 të LZP. Nga të gjitha kërkesa e dërguara nga Zyra për verifikim të kandidatëve të subjektit politik Listës Serbe, të gjitha janë kthyer pa të gjetura për kandidatët e prezantuar nga subjekti politik në fjalë, që nënkupton se të gjithë kandidatët e Listës Serbe plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që rrjedhin nga neni 30 i LZP. Pas përfundimit të të gjitha hapave të nevojshëm për kontroll dhe verifikim të aplikimit të partisë politike Listës Serbe për certifikimin e kandidatëve, në takimin KQZ të mbajtur më 10.12.2025, Zyra ka prezantuar rekomandimin për certifikimin e listës së kandidatëve të partisë politike Listës Serbe të përbërë nga tridhjetë e tre (33) kandidatë, për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Paneli ka gjetur se KQZ-ja, në mbledhjen e mbajtur më datë 10.12.2025, duke vendosur sipas rekomandimit të Zyrës për Regjistrim, Çertifikimin dhe Kontrollin Financiar të subjekteve politike në KQZ, nuk e ka miratuar rekomandimin e Zyrës për certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Lista Serbe, përkatësisht është konstatuar se rekomandimi për certifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Lista Serbe, nuk ka kaluar pasi që pas votimit të anëtareve të KQZ-se, tri (3) vota kane qene për, dy (2) vota kundër dhe kane qene gjashtë (6) abstenime, dhe si rezultat i këtij votimi rekomandimi në fjalë nuk ka arritur ti marr 2/3 e votave të nevojshme për tu certifikuar siç kërkohet me paragrafin 4 të nenit 63 të LZP.

Me dispozitën nenit 26 paragrafi 1 të LZP-së, parashihet që: *“Një subjekt politik, koalicion i subjekteve politike, ose nismë qytetare që ka aplikuar për certifikim për pjesëmarrje në zgjedhje i dorëzon Zyrës me kohë dhe në mënyrën e përcaktuar sipas rregullave të KQZ-së listën e kandidatëve”. Ndërsa me nenin 27 par. 2 i LZP-së parasheh që: “Zyra i shqyrton të gjitha listat e kandidatëve dhe në rast të përfundimit se subjekti politik i është përgjigjur kërkesave të Kapitullit III dhe IV të këtij ligji, atëherë i rekomandon KQZ-së certifikimin e listës brenda dhjetë (10) ditëve pas pranimi të listës”. Po ashtu edhe në Rregulloren Zgjedhore Nr.04/2024 të KQZ-së për Çertifikimin e Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre, përkatësisht në nenin 4 pika 5 shprehimisht parashihet që: “Zyra nëpërmjet institucioneve tjera përkatëse bënë verifikimin e secilës kërkesë për certifikim dhe të konstatojë nëse të gjithë kandidatët që paraqiten në listën e kandidatëve, përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 30 të LZP”, si dhe pika 10 “Pas pranimi të rekomandimit nga Zyra, KQZ e miraton ose refuzon aplikimin për certifikim brenda shtatë (7) ditëve”.*

Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës parasheh që: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.”*

Paneli, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe arsyetimit të KQZ-së të përmbajtur në vendimin e ankimuar të datës 10.12.2025, me numër protokolli 01/3771/2025, vlerësoi se një qëndrim i tillë nuk mund të pranohet si i drejtë dhe i ligjshëm, pasi bie në kundërshtim me dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e aplikimit dhe certifikimit të listës se kandidatëve të subjekteve politike, që marrin pjesë në zgjedhje.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) nuk ndan te njëjtin interpretim juridik me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për moscertifikimin e listës së kandidatëve të subjektit politik Lista Serbe. PZAP vlerëson se ky vendim është në kundërshtim me dispozitat ligjore të sipërcekura, pasi vetë KQZ-ja kishte përcaktuar paraprakisht planin dhe periudhën kohore brenda së cilës subjektet politike duhej të aplikonin për certifikim respektivisht listës se kandidateve, ndërsa subjekti në fjalë e ka respektuar plotësisht këtë afat ligjor. Në këtë drejtim, PZAP thekson se Zyra për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar në KQZ ka paraqitur një rekomandim pozitiv për listën e kandidateve të subjektit politik të Listes Sebe, duke konstatuar se subjekti politik Lista Serbe gjegjësisht lista e kandidateve të tyre i ka plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenet 26, 27 dhe 30 të LZP-së për t’u certifikuar për pjesëmarrje në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të cilat do të mbahen më 28.12.2025. Megjithatë, pavarësisht rekomandimit profesional dhe ligjërish të mbështetur, KQZ vendos ta refuzojë certifikimin e listës se kandidateve pa dhënë ndonjë arsye të vlefshme ligjore.

Nga shqyrtimi i vendimit të ankimuar, PZAP konstaton se KQZ nuk ka ofruar asnjë arsyetim për refuzimin e rekomandimit të Zyrës kompetente brenda institucionit, përkatësisht të Zyrës për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar të subjekteve politike. Vendimi i KQZ-së është i mangët, jo i plotë dhe nuk i trajton çështjet dhe faktet vendimtare që lidhen me vlerësimin e kushteve ligjore për certifikimin e subjektit politik. Në mungesë të një arsyetimi të mirëfilltë ligjor konkludohet se vendimi i tillë nuk mund të qëndrojë juridikisht pasi që nuk përmban as vlerësimin e duhur të fakteve në raport me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregulloren nr. 04/2024 për Çertifikimin e Subjekteve Politike.

PZAP vlerësoi se, kur subjekti politik ka respektuar afatet e përcaktuara nga KQZ dhe mekanizmi i brendshëm profesional i këtij institucioni ka konstatuar përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore për certifikim, është detyrim ligjor që vendimmarrja të bëhet mbi bazën e kritereve dhe faktit të vlerësuar në përputhje me ligjin dhe rekomandimet profesionale të mekanizmave të brendshëm.

Andaj, PZAP vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, konform nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht parasheh se: *“Nëse organi epror vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar, ai duhet të vendosë përfundimisht me një akt të ri që të anulojë apo ndryshojë, plotësisht apo pjesërisht, aktin e ankimuar, gjegjësisht do të nxjerrë aktin e kërkuar nga pala.”* Duke u bazuar në këtë dispozitë, PZAP ka vendosur të aprovoj ankesën e subjektit politik Lista Serbe ashtu që ka pranuar

rekomandimin e Zyrës për Regjistrim, Çertifikim dhe Kontroll Financiar i datës 10.12.2025, ashtu që e certifikoj listën e kandidatëve të subjektit politik Lista Serbe, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për certifikim.

Në pajtim me nenin 115 par. 1 lidhur më nenin 118 par. 1 dhe 5 të dhe 119 LZP-së si dhe nenit 13 par.2 të Rregullores nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
ZP.Anr.17/2025, datë 13.12.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.